

PLANI I VEPRIMIT PËR APLIKIMIN E STRATEGJISE GREEN TË FGJH

VITI AKADEMIK 2024

1. Qëllimi

Plan veprimi në vijim synon të përcjellë praktikisht pranë ambienteve të fakultetit tonë ndërgjegjësimin e kujt do që punon, studion dhe jeton një pjesë të mirë të jetës në këtë mjedis. Ruajtja e mjedisit nuk duhet të mbetet thjesht brenda mureve të këtij insitucioni por duhet të shtrihet edhe më tej duke ofruar kontributin personal për të ruajtur dhe për t'u kujdesur për të ardhmen e brezave që do të vijin.

2. Rëndësia e Mjedisit

➤ *Pse është e rëndësishme që të ruhet mjedisi ku ne punojmë e jetojmë?*

Të ruash mjedisin do të thotë t'i sigurosh të ardhmen Tokës për brezat që do ta trashëgojnë atë dhe do ta gëzojnë ashtu siç e gëzuan edhe ne.

Ruajtja e mjedisit është mjaft e rëndësishme për një sërë arsyes që ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e jetës në vendin ku ne jetojmë. Ndër këto arsye mund të përmendim vetëm disa si në vijim:

- Shëndetin tonë: Shëndeti ynë ndikohet drejtpërdrejt nga një mjedis i shëndetshëm. Kështu shpyllëzimi, ndotja e ajrit dhe ujit si dhe aktivitete të tjera të dëmshme mund të shkaktojnë probleme serioze shëndetësore, si sëmundjet e frymëmarrjes, sëmundjet e shkaktuara nga ndotjet e mëdha çënojnë rëndë aparatit tonë të frymëmarrjes dhe bëhen burim sëmundjesh të tilla që rrezikojnë jetën tonë dhe të dashurve tanë.
 - Diversiteti biologjik: Biodiversiteti është thelbësor për ruajtjen e stabilitetit të një ekosistemi. Çdo specie luan një rol specifik brenda një ekosistemi dhe humbja e një specie mund të ndryshojë ekuilibrin natyror.
 - Ndryshimet klimatike: Ndryshimet klimatike që ne vëmë re dhe për të cilat jemi të gjithë të vetëdijshëm. Ndryshimi global i klimës shkaktohet nga aktiviteti njerëzor, në veçanti nga emetimi i gazeve sërë. Të gjitha këto ndryshime kanë një ndikim të madh në motin, nivelin e detit dhe burimet duke përkeqësuar atë që është më e rëndësishmja cilësinë e jetës sonë aq e domosdoshme për mirëqenien tonë psiko- fizike.
 - Cilësia e jetës: Një mjedis i shëndetshëm dhe i pastër përmirëson cilësinë e jetës. Bukuria natyrore, biodiversiteti dhe disponueshmëria e hapsirave të gjelbëruara përmirësojnë mirëqenien njerëzore.
 - Etj.
- *Çfarë duhet të bëjmë ne qeniet njerëzore?*

Mund të bëjmë shumë por edhe asgjë. Kjo varet nga ndërgjegjja e gjithsecilit dhe nga vetëdija personale. Secili prej nesh mund të kontribuojë sadopak në çdo vend dhe në çdo moment në ruajtjen e mjedisit.

➤ *Si mund të realizohet kjo në FGJH?*

Pse mos të bëhemi nismëtarë dhe të shtrijmë nismën tonë kudo që është e mundshme. Le të ofrojmë shembullin tonë personal duke u përpjekur sadopak për të ruajtur mjedisin tonë, Tokën tonë të bukur ku kemi fatin të jetojmë.

3. Plani i Veprimit:

A. Ulja e konsumit të energjisë elektrike

❖ Klasat:

- Fikja e pajisjeve elektrike, elektronike pas çdo ore mësimore, por edhe gjatë saj nëse nuk janë më të nevojshme.
 - Kompjutera, Tabelat LIM, Videoprojektorët;
 - Fikja e dritave dhe kondicionerëve kur janë të panevojshëm;
 - Përdorimi me kriter i kondicionerëve në temperaturat e duhura;
 - Vendosija e pajisjeve elektronike në save mode – energy kur ato nuk fiken.
 - Kondicionerët gjithashtu mund të kenë një konsum më të vogël gjatë përdorimit duke i vënë në sleep mode – eco mode.
 - Përdorimi i dritës natyrale kur dita është e kthjellët, kjo pasi ndikon pozitivisht edhe në aspektin psikologjik

❖ Departamentet & Zyrat:

- Fikja e pajisjeve elektronike pas orarit të punës por edhe gjatë tij nëse nuk përdoren;
 - Kompjuterat, printerat, fotokopjet, distributorët e ujit.
- Fikja e dritave, kondicionerëve pas orarit të punës por edhe gjatë tij nëse nuk janë të nevojshme;
- Përdorimi me kriter i kondicionerëve në temperaturat e duhura;
- Përdorimi i dritës natyrale kur dita është e kthjellët, kjo pasi ndikon pozitivisht edhe në aspektin psikologjik;
- Vendosija e pajisjeve elektronike në save mode – energy kur ato nuk fiken.
- Fikja e plotë e çdo pajisjeje gjatë natës, fundjavave, festave dhe pushimeve.

❖ Korridoret & tualetet

- Pajisja me ndriçim me sensorë që mundësojnë fikjen në mungesë njerëzish.
- Fikja e bolierëve gjatë natës, fundjavave, festave dhe pushimeve.

➤ Institucioni:

- Pajisja me drita led që kanë konsum të vogël të energjisë

B. Pakësimi i përdorimit të letrës

❖ Personeli - Departamente & Zyra

- Përdorimi i tezave elektronike në klasë (teams, google forms, etj.).

- Përdorimi i formateve elektronike të dokumentacioneve, ruajtja dhe konservimi i tyre në dosje përkatëse;
 - Për të shmangur humbjen e tyre për shkak virusesh apo hakerimesh, këshillohet përdorimi një disku të jashtëm
- Përdorimi i QR kodeve apo linqeve për hartimin e pyetësorëve të ndryshëm me qëllim eliminimin e përdorimit të letrës;
- Përdorimi i firmave/vulave elektronike për dokumentacionet;
- Përdorimi i printimit të dokumenteve nga të dyja anët;
- Dy-përdorimi për nevoja të brendshme teletrave që janë përdorur vetëm në një anë dhe nuk nevojiten më;
- Përdorimi i printerave & fotokopjeve vetëm për nevoja akademike dhe jo ato personale.

➤ **Institucioni:**

Për regjistrat e zyrave kërkohet të mundësohet një sistem/një platformë përbashkët arkivuese që mundëson mbledhjen e të dhënave për çdo student në format të arkivuar, pa pasur nevojë për regjistrat e pedagogëve në të cilin do të hidheshin në mënyrë elektronike mungesat e studentëve si dhe orët mësimore të zhvilluara. Marrja e mungesave në format elektronik, e lidhur kjo edhe me sistemin E-student mundëson përlllogaritjen me përqindje të pjesëmarrjes, si dhe futjen apo jo në provime nëpërmjet sistemit. Kjo duke i bashkëngjitur edhe pyetësorët për lëndët para sezonit të provimeve ku secili prej tyre është i detyruar të plotësojë pyetësorët përkatës.

C. Pakësimi i ndotjes së ambienteve

❖ **Studentët & Personeli**

- Të ndalohet hedhja e mbeturinave jashtë koshave përkatës;
- Të mos lihen mbeturina të ambalazhimeve ushqimore poshtë bankave;
- Të mos hidhen mbeturina dhe bishta cigaresh në oborrin e fakultetit;
- Të ruhen pemët dhe lulet brenda dhe jashtë fakultetit;
- Të mos shkarra viten dhe njollosen muret, tavolinat apo çdo ambient tjetër.

➤ **Institucioni:**

- Vendosija e koshave të mbeturinave në çdo ambient të FGJH.
- Monitorimi i ambienteve me kamera me qëllim identifikimin e ndotësve dhe marrjes së masave.
- Vendosija e koshave për selektimin e mbeturinave.
- Marrja e letrës me qëllim riciklimin e saj.

D. Ruajtja edhe konsumi i kontrolluar i ujit

❖ **Personeli & studentët**

- Mbyllja e rubineteve;
- Kontrolli i pajisjeve hidrosanitare për rrjedhje;

➤ **Institucioni**

- Vendorsja e shkarkuesëve të kontrolluar të banjës me kontroll për 2 funksione.
- Vendorsja e rubinetëve me sensorë me kohë të caktuar.

E. Shtimi i gjelbërimit në ambientet e brendshme të FGJH.

- Vendorsja e luleve dekorative dhe natyrale në të gjitha ambientet e brendshme të FGJH.